Vera Istrefaj
QIELLI I SHPIRTIT TIM



LSHA&Kukës

& & &

Redaktor: Novruz Xh Shehu

Recensentë: Shyqri Galica
Gëzim Ajgeraj

U kujdes për kopertinën: Refki Gollopeni

Vera Istrefaj

Lirika

Botoi

X Y

2014

Asgjë s'u dëgjua sonte
veç një përplasje gotash

GJETHNAJË PRANVERORE

Ka ardhur pranvera.
Do të vesh fustanin,
do të vij të qoshja,
ku pema
lëkundet
tek na rri mbi krye.

Me të dalë dielli
fustani do të shndrisë
gjethet do të gjethojnë,
kurorën e dashurisë

BRYMË...

Thana,
e para çel,
e fundit piqet.

Gjatë i gëzohet lulëzimit,
për t'ju shmangur vjeljes.

Vetë,
u poqa pa lulëzuar.

Askush s'kujtohet,

thanën ta shartojë.

Bryma ma zë frymën,
ndërsa thana piqet...

E RUAJ PUTHJEN TËNDE

Si perlë gjerdani
që shkëlqen shpresat
e driton
terrin e mungesës tënde

Si trëndafil
aromëndjellës
mbi qiellin
e shpirtit tim

Rreze
akullshkrirëse
që largon cdo trishtim

E ruaj në anën e majtë të gushës
atë nishan të zi
që kujton puthjen...

MË PRET

Më pret,
edhe kur jeta fytyrën

ma mbulon me trishtim.

Kur mbi mua
shkëlqen pranvera,
më pret si ngahera.

Zhytem në gjirin e tij.
Kështu ndjell gjumin,
e zgjohem të nesërmen

Ai më buzëqesh,
sikur më thotë:
“Tërë jeten të pres”

PËRQAFIMIN SI NGUSHËLLIM

(Lulëmirës -Vogëlushes së Kosovës që erdhi në Kukës në ditët e dyndjes tragjike)

Lulëmirë
nuk t’i shoh sytë
veç copëzat e tyre
si copëza kristali
tek plasin dhimbjet

Për lojën tënde
të lënë diku,
për lodrat
e mbytura nën tank.

Për rritën
e varur
në pragun e kullës
së shkrumbuar

Çfarë t'i jap
ngushëllimit tënd,
vec një përqafimi
dhe lotin tim
të dhimbjes?....

22 maj 1999

Ç'ËSHTË KJO HESHTJE MES NESH

Buzëve të ngrijnë
fjalët e pathëna,

Ç' është kjo heshtje?!

Çerpikëve të varen
shikimet e shmangura,

Ç' është kjo heshtje?!

Duarve të shtrydhen shtrëngimet
e etjeve të pashuara

Ç' është kjo heshtje mes nesh?

Nëpër dridhmat e trupit

t'i lexoj dëshirat

Eh, kjo heshtje mes nesh!

VJESHTË JO E ZAKONTË

Vjeshtë jo e zakontë,
ka ardhur brenda meje,
jo nga zbehtësia e stinës
as nga vyshkja e moshës,
por nga trishtimi...

Unë përmallshëm shkel
gjethet e blirit

Me pika shiu
freskoj dëshirat zemrës,
ballin ia ngroh
me diellin vjeshtak

Kurrsesi këtij trishtimi
s'i vë emër
e një zambak mbjell
në zemër...

KËSHTU

S'mund të mos mendoj për ty.
Në çdo çerpik tëndin
therur e kam shpirtin

Në detsyrin tënd
mbytur kam lëngatën

Shkrihet puthja ime
aty ku ti drithmat ia ndien
dhe ti…

Ti nuk e di sa larg e pranë jemi

Në ëndërr të ledhatoj
nëpër faqe
e me gishtat e mi
trazoj dridhmat e etjes tënde

Kur të kam pranë
heshtja më mban rob
deri sa ti ma ndien ritmin e zemrës

Më deh kjo ritmike!

Me ty i kam bërë bashkë
dëshirat, dhimbjen, dashurinë

Ndjesi e pazakontë!

SHUMË HERË

Shumë herë
mbrëmjeve,
i bëj gërsheta dhimbjet…

Në dyzet vitet e mia

supet më mbeten të brishta
e ëndrrat të trishta

Vë mbi gërsheta
fjongo
dukem bukur
në përpëlitje të jetës...

I buzëqesh vetes
përballë pasqyrës,
jeta më sfidon
me shenja të fytyrës

Mbi motet e mi,
një nga një i palos
brengat...

MOTIV I ËNDËRRËS

Shpesh
i përkëdhel ëndërrat
si dy djemtë e mi
t'i vë në qetësi

Ndodh
që sapo vë në gjumë
një ëndërr të vjetër,
përkëdhel një tjetër

Në përkëdhelje
gishtat më janë tretur,
ninullave
zëri më është mekur

E, përherë
një motiv të ri
kam për ënderrat,
për djemtë e mi

EJA ME MUA DRIN

Eja me mua, Drin,

S'di kush vuan më tepër,
a më pak nga ne

Ty të ndryshojnë shtratin,
mua më bëjnë pre.

Eja me mua, Drin,
të vërshojmë udhëve
T'i themi lamtumirë
qetësisë së gënjeshtërt

Se të dy,në vrapimin e lirë,
këtu, jemi të tepërt.

Eja me mua,
të vërshojmë udhëve

S'di cilin Dri të zgjedh,
këtë fundvjeshtë...

Drini i Bardhë dhe i Zi
ejani tek une
të vërshojmë udhëve !

Në sallonin e vetvetes
mbeta thjesht shërbëtore e huaj

S`ERDHE

Kur s`vjen në mendjen time
një ditë të vdekur kam jetuar...

Ëndrrat do t'i marr në krahë
të perqafoj mallin
e mungesës tënde...

Ti gjej vetëm arsye,
mosardhjes mos i shkëput
urat e shpresës

Dergomë një përqafim
ta shtrëngoj fuqishëm...

NË SYTË E TU

Zjarrmon lakmia ime
detit të syve të tu,
harrohem valëve të tyre

lë veten aty-këtu...

Shumëcka
ka ndodhur mes nesh
dallgëve të jetës trazuar

Nga plagët e jetës
shpirti shkrumbuar

Çlodh ëndërrat
qetësisë tënde
të symbylljes

SHENJA VJESHTE

Udhëve përkundem,
mendimet përzihen .
Sa shpejt po bie tisi vjeshtor

Jeta
m'i rrotullon motet,
pa më pyetur për dëshirën
nëse do i jepem stinës

Pesha e kohës
gërryen vitet e mia
si lumi brigjet
Hetueshëm m'i vjedh
fletët e librit te jetes...

Vjeshta
shtrëngon ngjyrat,
merr udhën
e fluturimit të gjethes

MOS MË HARRO

Dritaren do ta lë hapur
të më vish si trumcak.
Etjen buzëdjegëse
ta shuajmë pak nga pak

Edhe nëse vonë
eja!

Të lutem
eja këtë pranverë

Pranë dritares do të më gjesh,
mallezuar për ty,
si një shtatore...

KUR TË KALOSH TI

Kur të kalosh, ti, rrugës time,
mbaj vesh.
Aty është zëri im prej fëmije,
e qeshura pa kufi.
Edhe të qarat, janë aty.

Zhurmshëm,
hapat e mi do të zgjohen.
Ka kohë që nuk ndihen.
Ke për të parë një vend,
ku jam ndalur, bashkë me frikën.

Aty do të jetë,
drithërima e dashurisë së parë.
Edhe lotët, po aty.

Kur të kalosh,rrugës sime,
do të xhelozosh,e di,
por, aty e deri këtu,
kemi qenë veç une e vec ti.

Kur të kalojmë bashkë,
s'do të kemi kohë të kujtojmë,
se sa jemi dashtë.
Femijët, do të na tërheqin
të luajnë,të qajnë e të qeshin..

NË SOFRËN TUAJ

Në sofrën tuaj të madhe
po afrohem, e di
do të më cysni si macen
poshtë sofrës me bezdi

Një lugë e rënë në tokë,
një e nëmur në erë
si do që të jetë
unë përherë mbetem Verë

Të ju shoh nga lart unë dua
s'ka rëndësi ju mua
për këtë arsye të thjeshtë
ju mbeteni "mbarimvjeshtë"

NË SHPIRT E LËNDUAR

Më fle dhimbja,
në zemër dicka tjetër
më shumë se neveria
për ty, ndjenjë e vjetër

Herët apo vonë
do të ndodhë
përballje të kemi
unë dhe ti, gjithsesi

Kështu njëri- tjetrin
ta shohim në librin e syve.

Ti nuk mund të fshihesh
kurresi

Koha i shëron plagët
por jo dhimbjen e fjalëve...

RËNDIM ÇERPIKËSH

Më rëndon mbi çerpikë,
pushi i rënë nga plepat

Vështrimi
 më humb qartësinë...

Në rrapëllime qerpikësh
shkund flokët
nga pushi i plepave

Eci
si një princeshë
e plagosur prej bukurisë

KUJTIMET FLENË

Kujtimet flenë brenda meje
si zanat e malit
nën hijen e pemës

Në heshtje
grimoj shpresën
me rimel blu

E dëshirat struken
sa aty, sa këtu.

Vetëm syve ua kam frikën
e s'mund ta fsheh vetveten

UJËVARË NË SHPIRT

Funddimri,
pragpranvere
Ngrohtësi brënda meje

Më ngjethet trupi,
vërshojnë
lumenj dëshirash

Mbeten ujëvara,
që s'dinë ku të derdhen.

Ndjej muzikën e Verdit,
Moxartit,
 më ushton
tastiera e zemrës

Në ujëvarën e shpirtit
një pulëbardhë
kërkon pak ujë të qetë
diku nëpër det...

DHIMBJE E PËRJETSHME

Asnjë melhem s`e shëron
plagëdhimbjen
për humbjen e foshnjes së parë

Mungesë e përjetshme

Si një pallto e zezë
trupit rri dhimbja

Heshtje në lot,
mbrëmjeve të vona,
e mëngjeseve të hershme

Zërat e fëmijëve më ftojnë
në lojën e saponisur

Ngashërimi mbetet diku,
brënda meje...

Dhimbje e përjetshme

TEATRIT TË JETËS

Është dramë jeta
 me një akt

Është e pafund

Aktorë në jetë janë
të gjithë,
ose një i vetëm

Gjithçka tjetër
mbetet pas kuintave.

Suksesshëm kush luan
del i kërrusur.

SKAJ BLIRËVE TË QYTETIT

Rradhë- rradhë,
shkojnë e vijnë ditët e netët
blirëve të qytetit

Skajit të trotuarëve
shikimet dhe blirët
të parët përqafohen

Të rinjtë
lakmojnë gjethet
tek pikojnë bukuri
trotuareve...

ZBRAZËTI

E mbush zbrastësinë time
në ikje të përhershme
përtej vetes

Copëzuar më është jeta
kësaj ikjeje
tek shtrëngoj në gji
padjallëzinë

I jepem harresës.
E lodhur tërheq flokët
e zgjimit

Zgjoj dëshirat
e etjes rrebele
deri në arritje
të qëllimit…

NDJENJË

Unë dhe vetvetja
kemi diçka të shtrenjtë

Në tavolinë
ulemi çdo mbrëmje.
Mundohemi të bindim
njëra - tjetrën

S`dime të ngopemi
tek ia kafshojmë
buzët mendimit

Me ndjenja të ylberta
bashkë jemi lidhur
dhe trazojmë etjen

Edhe gjumi
s'na pushton të dyjave
njëherësh

MBRËMJA

E veshur me mantelin e zi,
e heshtur mbi rrugë
verbon

Rënduar vetmisë
eci trembshëm
e territ të saj
ia fal dritën e kujtimeve

Marr me vete
copëza ëndrrash
që s'më lënë
për asnjë çast

Shpirti im
s'njeh kufij kohore

Një mbrëmjeje
dhe shpirtit tim

iu vërbuan ëndërrat...

PO SHUHEN QIRINJTË

Qirinjtë e gëzimit...
Mos m'i shuaj!
Të urrej
pse të dua marrëzisht!

Diellin tënd
kanë harbuar
hijet e dyshimit

Një ditë do ia zërë dritën,
kur të bjerë
perdja e mashtrimit

Po më mbyt tinëzisht...

Nata po afron!

M'i ke lënë buzët në gjysmëputhje,
më ke lënë gjysmëvdekur...

ÇASTE BRËMJEJE

Ajri mbrëmjes
përzier me erën e blirëve
ndanë rrugës

më ndjellin ndjesi
paqeje...

Krisma e takave
shoqëron çastet
e dehjes sonë
skajit të trotuarit

Bukur u rri mbrëmja
casteve të lumturisë...

NË PRITJE

Po ngryset vetmia,
ka pushtuar brigjet
mbi rrafshin e liqenit

Shkëmbinjtë, shkurret,
pushtojnë shikimet
nëpër horizontin e murrmë

Yjet shpojnë qiellin,
territ flenë ndjenjat
e udhëtarëve të lodhur

Kthimi yt
humbur kthimeve...

I PËRULEM ZEMRËS

Më vuan shpirti
për një buzëqeshje

Shpirti im
s’njeh përulje për mbret
as për pallate mbretërore

Sonte
dëgjoj klithmën e shpirtit
dhe thirrjen e zemrës

Dikujt një buzëqeshje,
a një fjalë të ëmbël i fal

Nesër dua të zgjohem
plot jetë!

GOJËLIGËT

S'ia kursejnë emrin
në bisedat banale

Ia nxijnë përshkrimin,
ia plandosin në pluhur

Kur pranë tyre kalon thonë
"është e bukur"
Në gushë
duan t'i vënë varëse të fajësisë

Ajo s'vë asgjë
falë thjeshtësisë

Në fund të ditës
ia lajnë mëkatet...

NGASHËRIM

Asgjë s'i bëhet pengesë
lumit të ngashërimit tim

As guri mbi liqen,
as vesa mbi gjethe dushku
askush s'ma ndal
ngashërimin

E lë lotin lirshëm
të mbarojë shëtitjen

Zgjas vetëm dorën
të marr me vete
dhimbjen

RROKULLISJE

Tok me gotën
rrokulliset diçka tjetër
Ishte nisur për t'u thyer
kjo tavëll e vjetër

Rrokullimë, rrokullimë, rrokullimë
Hej, ku vete?

Lërma shpirtin...!

Tok me ciflat në tavolinë
u mblodhën pjesë të shpirtit tim...

Shëndrin tryeza veç për pak,
me të tilla mbushet prapë.

SI DEGË E THYER

Kam rënë
si degë e thyer përtokë.

Era e dhjetorit më shkund
sa andej këndej

Nuk më gjethojnë më
sythet e zemrës,
 kapluar i ka
zbehja e fundvjeshtës

As pema e shpirtit
më nuk fruton...

Ngrica e vesës së largësive
lëngon

Trishtueshëm ra
vesa e funddhjetorit

CAQET E VETVETES

Caqet e vetvetes
s'munda t'i kaloj
ndaj e tillë mbeta, pa famë

E thjeshtë
si lulja në bjeshkë
nën hijen gjethedushk,
qoftë edhe një pikë ujë
pa i dhënë askush...

Njerëzit
lartësitë preferojnë
e unë
rrënjëve të caqeve të vetvetes
eci, vetëm eci...

SHI MALLI

Shi malli kam
Largësitë e tua
pikojnë strehëve...

Rrufetë e mallit
më therin në zemër

Më përplasin tronditjeve,
mureve te shpresës...

Mungesës tënde
ia kam frikën!

Në qiellin e shpirtit
arnoj
plagën e vjetër...

PUTHJA

Prej teje
shkëputur është flladi i puthjes
e pezull mbetur ka
mes meje e teje

Në dhimbje zemre
ka zënë vend e s'luan

Mbështjellur
më je rreth trupit,
e lëmsh i je bërë në grykë
qetësisë time

Lermë të qetë
në vetminë e zhurmshme!

Buzëve të tua
lodron puthja ime
e t'i përflak ëndrrat

Ta vras timen, apo një zemër tjetër?!

Të përbuza, jo për të thënat
por për të pashprehurat...

AKULLDJEGIE

Trupi yt,
në akuj digjet.

Duart,
mbi prush të mërdhijnë.

Me të qara,
luan simfoninë.

Mes belbëzimesh,
vallëzon jeta.

Unë të tërheq
për dore,
nga vetja.

SA VËSHTIRË

Sa vështirë të lindësh në rrëzë
e të ndjesh se s'jeton dot
pa aromën e luleve
të majës së Gjalicës

Përherë e pangopur
vetëm sa frymoj
 në stinën e shkurtër të verës.

Sa pak jetoj!

Më merr udhë shpirti
gurëve të çmendur
që vetëm rrokullisen...

Në zvarritje
më mbeti shpirti,
gjakosur me dhimbje
i heshtur në piskamë.

Sa vështirë kurorëzimi në majë,
kur, veç aromën e luleve
ke si pajë

VEJUSHË

Në shpirt e vrarë,
nën rroba të zeza
të dridhet trupi
vejushë
Diçka
shpirtin për të të ngrohur
s'të ofron askush
Nëse të nesërmen,
prapë do të jetë kështu
mos ardhtë kurrë
mëngjes për ty!
Gjithcka shkrumbuar,
dhimbja jote u bëftë hi!

NDJENJË E DHIMBJE

Fletëve të trëndafilit
vesuar më ka gëzimi
Rrënjëve të tij

ujit lot-hidhërimi
Ndër gjemba zvarritet
mendimi im i mjerë
gjersa të shpërthejë
gonxhe në pranverë

ETJA E LARGËSIVE

Më lini të digjem
në këngët e mia

Kam zjarr brenda vetes,
për të shkrirë akujt...

Ma lini jetën me halle
veç mua,...
S'po kërkoj gjë hua

Mos ma shqelmoni shpirtin
se vetëm ai më ka mbetur

Lërmani lotin,

të më rrjedhë hijshëm

poshtë syve,
ta shuaj etjen e largësive

MES VARGJESH DO TË MBES

Në rrugën e pafund,
mendimet i përkund
Muzën e mendimit e ndez,

mes vargjesh të zbres

Edhe nëse askush

s'do të pyesë për mua

diçka do të të lë si kujtim

Diku ...ja diku...

copëz e shpirtit tim

MË LINI NË MËKATET E MIA

Natyrshëm krijova

timin portret

Një ditë,

po natyrshëm

e gritha

Në çjerrje të lëkurës
mes dhimbjesh
copëza kujtimesh gjalluan,
e prapë
ca ndjenja më pushtuan...

Në trurin tim
flenë ëndrrat...

Unë e di
nuk jam perëndia.

Në këtë botë, mbushur mëkatesh,
lini pak vend për mëkatet e mia!

E DI

E di
se edhe këtë dimër,
dëborë do të bjerë

E unë,
gjithnjë e më tepër,
do të ndjej të ftohtë

Por buzëqeshjen,
do të ma shikoni në buzë,
si përherë,
të ngrohtë

MUNGESË FRYMËZIMI

Prapë nuk po vjen!
Më kot kam pritur
S'di në ç'portë të trokas

Sikur të takohemi

qoftë edhe një herë,

mbase nata për mua

s'do të kishte terr

As dielli perëndim s'do të kish

Mos ma kurse këtë ndjesi,

vargu im!

NËPËR COPËZA MBRËMJESH

Nëpër copëza mbrëmjesh

shfrytëzoj pasqyrën për buzët

...

Më tej gjithçka mbetet e hedhur

si fundet e cigareve në tavëll

Copëza mendimesh

përqafojnë muzën

ndërsa kërkoj

të bëj paqe me gjumin.

Shi malli më bie në shpirt,
por zjarri s`shuhet se s`shuhet

COPËZA NDJENJASH

Të përbuza

jo për të shprehurat,

por për të pashprehurat

***

Të urrej

pse të dua marrëzisht...

...pse më mbyt tinëzisht ?!

***

Sot hutueshëm edhe zogjtë fluturojnë

folenë e ëndërrave ndërtojnë..!

***

Shiu i fundit m' i ka lagur flokët

era do të më ndihmojë t'i thaj,

por shiun në zemër

si ta mbaj?!

***

Gur varri do të bëhem,

vetëm të jem pranë teje!...

***

Pika shiu më ranë mbi flokë,

shkrumb mendimi kam në kokë

***

Sytë e tu lodrojnë mbi gjoksin tim

sytë e mi pështirosin sytë e tu

Ku të ta fundos shikimin?

***

Çdo ditë e gënjejmë veten

me vezullime të gënjeshtërta

***

Thonë se kam ecje të butë
e si një flutur, të lehtë...
por membranën e faqes
përherë të zbehtë

***

Me takat e mia të lehta
nuk e shpoj as tokën
Si ka mundësi zemrën?!

***

Ajër ka për të gjithë:
Unë frymova vetëm pjesën time,
ty të të ndalet zemra
nga te miat mendime?!

***

Më djeg diçka,
Vështirë t'i vë emër
Malli për ty
shkrumb në zemër

***

Nën jorganin e qefintë
mbarset koha
me shpresën e ngrohtë
të lindë një djalë
Do ta festoj pranverën që vjen ...

***

Shumë netë
m'i shkallmon pagjumësia.
Në batakun e zhgënjimit
gulçon shpirti.
Më mjegullohen mendimet
nga mundimet...

***

Embël më plagose
në zemër,
Një pjesë të saj ma more,
një pjesë ma le

Të gjalloj e vdekur...

***

Grimcat e kujtimeve

më shpërndahen

tek heq pluhurat mbi orendi

Në në dhimbjen time

të rrokullis

e lotët i mbaj në sy...

***

Jam esëll për gjithçka

në dhembje e gëzim,

E vetmja gjë që më deh

e folura e paplotë

e voglushit tim

***

Çarçafi i zhubrosur provë fajësie

e pafajësie njëkohësisht.

Këputja jonë prehet mbi të...

***

Mos u verbo nga sytë e zemrës

Ata mund të të mashtrojnë,

të të cojnë errësirave të jetës

***

Buzëve përshpëris

e s' ngopem duke ujitur

gonxhet e dashurisë

***

Në mbrëmjen e vallëzimit

vathi më mungoi

Mbi shpatullën tënde

vezulloi

***

Trëndafili, sado i bukur që të jetë

pas vyshkjes, lë veç gjembat.

Shtrëngoj fort fëmijët e mi.

***

Pikojnë strehët e pallateve,
në dhimbjen time.
Heq këmbët zvarrë,

nën heshtat e shikimeve...
***

Këtë mëngjes,

të gjithë duken të fjetur

Dhe mjergulla mbi qytet

fjeti.

Ndërsa, unë tërë natën,

me dorën tek djepi

***

Mes perdeve të tylta,

natyra më fal

qindra rreze përtëritëse,

që mblidhen të tëra

petal,

mbi fytyrën e foshnjës time...

***

Do të të jepem e tëra po me atë forcë me të cilën s'do të të jepesha kurrë

NËSE

Nëse s'të takoj

do të të pres në botën tjetër
Gur varri do të bëhem
nëpër pritjen tënde
Ne aromë te luleve
që ti do të më sjellësh
do ta çlodh
ekstazën e shpirtit
Pafundësisht do të të pres
si një rrezeshpresë...

VETËM TRE

Ndonëse katër në numërim
ishim tre në tavolinë
Mbase ishe edhe ti,
për mua kurrësesi
S'di ku të treti tjetra pjesë
në të shara a në shkesë
Ishe sot, ti, bashkë me ne

por për mua ishim tre

NJERIU I MIRË

T'u desh

kokën ta ulësh

t'a kthesh pas

Unë vura buzën në gaz

E di.

ti s'do të ndjellësh

keqdashjen

ndaj,

nuk bën pakt me ngasjen

Në ikje

me sy më përkëdhel,

me dëshirë

E unë nuk kam frikë

nga njeriu i mirë

NË KRISTAL TË DËBORËS

Tutje- tëhu hoqa zvarrë

një pjesë të vetes
nga toka në re
Në kristal të dëborës
më ngriu
imazhi i harruar
Hoqa zvarrë
pjesën e mbetur
dhe veten pashë:
Gjysmë gjallë,
gjysmë vdekur.

VRAPIT TIM

Në vrapin tim
drejt skajit fundor të jetës
në harresë lashë dashurinë
si një rrobe të bukur,
por që kurrë
s' ke rast ta veshësh

Pluhur ka zënë,
por ende mban
aromën e parfumit dehës

Në vrap e sipër
në kurriz më rëndoi humbja,
fitorja, shpresa.

Ndonëse vrapova
mike m'u bë vonesa
Vonë, shumë vonë!
Edhe agimi i ditës së sotme
është i vonë,
njëherësh
start për vrapin tim.
Çuditërisht,
më buzëqesh dashuri e harruar,
por tepër vonë.
Në grykëtharje, etje të pashuar

rrënjëzon dashuri e harruar
S'di kur më erdhi
e kur më iku rasti
rrobën e bukur t'a veshja,
e s'do të kishte rëndësi
nëse më vonë
do të qaja apo do të qeshja.

VETËM SYTË E TU

Shumëçka ka ndodhur
Si gjithmonë
në sytë e tu
diçka jo e zakontë
më tërheq
S'di ç'më ka trokitur në derë
e keqja apo e mira?!

Shumëçka ka ndodhur
Vetëm në sytë e tu
ka mbetur jozakonshmëria.

PËR TË QENË ME TY

Për të qenë me ty
më duhet të jem
engjëll e djall

Tjetër gjë s' ndiej
veçse mall

Të ndarë
s'kemi sy për të parë

Luleferrë e dashurisë
prani e xhelozise

KOHË E VERDHË

Thonë
në fytyrën e të vdekurit
lexon lamtumirën

Këto gjurmë
shpeshëherë po i lexoj
në fytyrat e të gjallëve
Verdhësi e kohës
pushton çdo skaj të botës
Ç' trishtim!

Ç`TË SHASTISI

Ç'të shashtisi, kalimtar ?
Flokët e dendur
a syri ulli?

Ti s'ke faj

Ka kohë
që kam ndjerë
nevojën e mbledhjes së flokevë

Ti ec, kalimtar

me vete merr imazhin e mosbindjes
dhe mbaj mend
sa herë të kalosh këtu
në këtë vend,
do të shohësh patjetër një vajzë
me flokë të shkurtër a të gjatë

Në to
do të kalojnë gishta
erëra e mendime,
jam e bindur,

nuk do ta harrosh
flokëkurorën time

Ik kalimtar,
me vete
heshtjen tënde po marr...

Vetmia në gjysmëdremitje griset
më ngacmon muzën e mendimit poezia

TË HUMBUR

Të humbur ëndrrave
shëtisim bashkë
në shëtitoren e vetme të qytetit

Pa dashur, pa ditur,
pushtojmë hapat e njëri-tjetrit.

Erërat
flladisin etjen e lakmitarëve
e ëndrrat ua fundosin
nën valët e Drinit

E ne shëtisim
pa dashur, pa ditur,
në shëtitoren e vetme

të qytetit
Lakmitaret
i lemë si gaztorët e mbrerit

NJË ÇAST

Rrekem të mbaj rob
një çast,
i cili më shkakton
ndjesi të akullt...

Në këtë çast,
ndjesi të panumërta,
trazohen në shpirt
e rrebelohen zemrës

Shpirtin ma pushtojnë
akullnajat ,
të ardhura nga jashtë
më ngrijnë të tërën

JARGAVITJE

Erë qepësh të njoma
vijnë duart e tua
Trupit tënd
aromë epshore
Jargaviten burrat
e harrojnë të hanë
ushqimin
prej teje servirur

AH, KJO DHIMBJE

Ditët që po vijnë
do të kalojnë

Klithmat e dhimbjes time
askush s'i dëgjon

Unë do të hesht
e heshtazi do të mëkoj
plagët e mia

Ndryshe
do të shihni një trëndafil
ose të gjakut, një curril

E TILLË KJO BOTË

Kam frikë
nga mendimet
që udhëtimin nisin nga truri
në zemër

Nëse në një çast
shfaq dobësi:
më ndjeni,
jam njeri

Të kundërtën dua,
e tillë është kjo botë
për mua

MOSHA

Më trishton
molla e kafshuar,
hedhur në rrugë
ndanë trotuarit

Kam frikë,
mos një ditë, e tillë mbetem
edhe unë
hedhur në vetminë time.

KUR S' TË SHOH TY

Kur nuk të shoh,
një ditë të vdekur
kam jetuar
Endërrat
më marrin në krahë
e me flatra fluture
më sjellin

në gjirin tënd
Mall për ty
Kur i çel sytë
dëshprimi më vret në shpirt

Kujdes me ndjenjën time
Një fill kam mes dashurisë e urrejtjes

ETJE E TRAZUAR

Qetësitë e netëve
notojnë detit të trazuar
të shpirtin tim...

Asgjë tjetër s'dinë.
veçse të notojnë
me vrullin e etjes
për ty

E mbytur jam
furtunave të shpirtit

të trazuar

FJALËT E TUA

Fjalët e tua rrëke,
mblidhen në detin tim
të dëshpërimit

Heq copëra nga zemra
t'i bëj vënd qetësimit

Të kam përshëndetur
ngrohtë në rrugë
ashtu thjeshtë
Nuk e dija
se thjeshtësia ime
tërbonte mendimin tënd

Për mua s' ka rëndësi.
Përshendetja ime
e ngrohtë do të jetë, gjithsesi

HESHTJE E SHPRESË

Heshtje,
vetëm heshtje.
tek thur trikon e djalit,
e shtizat nëpër duar
kryqëzohen

Thur trikon
me vija të bardha, jeshile.

Vija - vija
shpresa ime

RISI TRAZUESE

Më parë

s'mendoja për krisje qelqurinash

e buzëqeshje të shtirura

Sot

nuk e di ç farë kam:

Grindem me veten

Vetëgrindja

i vetmi rrafsh pasqyrimi

për mua

KOHA

Koha,

u soll dinakërisht me mua.

Edhe përkëdheljet e saj
ishin dinake.
Mëkatarët,
vrapojnë pas kohës...
Vuajtja ime,
është shumëngjyrëshe
Kam frikë nga e kaluara.
I zgjas dorën vetes,
i them
Eja!

DHIMBJA DIGJET BRENDA

Nuk bien lotët

por rimojnë zhurmshëm

mbi lojën e dhimbjes

Heshtja më ther në zemër

Pamundësia për të folur

digjet buzëve,
zjarrmi e paemer

S`DI NË Ç`STINË

S'di në ç'stinë,
çmënden mendimet e mia?!

Në Pranverë?
Jo!
Aroma e luleve,
më fal qetësinë
Në verë?
Nxehtësia më struk
në hijen e shtëpisë
Vjeshta?
Veç dëshirës për fruta,
asgjë tjetër
Eh, dimri!
M'i ngrin mendimet

Ç'është kjo stinë që s'di kur vjen,

e kur shkon?!

DHIMBJES S'I DORËZOHËM

U mësova me dhimbjen e plagëve

e therjen në zemër

Stuhinë e ëndërrave

e mposhta

Në fitore e humbje,

njësoj

veçse jam femër

* * *

Përmbajtja e librit:

Asgjë s'u dëgjua sonte
veç një përplasje gotash..... .....fq4
Gjethnajë pranverore..... fq5
Brymë..... .....fq 6
E ruaj puthjen tënde..... fq 7
Më pret.....fq 8
Përqafimin si ngushëllim..... fq 9
C'është kjo heshtje mes nesh.....fq 10

Vjeshtë jo e zakontë..... fq 11
Kështu.....fq 12
Shumë herë..... fq 13
Motiv i ëndërrës.....fq 14
Eja me mua Drin..... fq 15
Në sallonin e vetvetes
mbeta thjesht shërbëtore e huaj.....fq 16
S'erdhe..... fq 17
Në sytë e tu.....fq 18
Shenja vjeshte.....fq 19
Mos më harro.....fq 20
Kur të kalosh ti..... fq 21
Në sofrën tuaj..... fq 22
Në shpirt e lënduar..... fq 23
Rëndim çerpikësh..... fq 24
Kujtimet flenë..... fq 25
Vetëm syve ua kam frikën
e s'mund ta fsheh vetveten..... fq 26
Ujëvarë e shpirtit..... fq 27
Dhimbje e përjetshme..... fq 28
Teatrit të jetës..... fq 29
Skaj blirëve të qytetit..... fq 30
Zbrazëti..... fq 31
Ndjenjë..... fq 32
Mbrëmja..... fq 33
Po shuhen qirinjtë .....fq 34
M'i ke lënë buzët në gjysmëputhje,
më ke lënë gjysmëvdekur..... fq 35
Çaste mbrëmjeje..... fq 36
Në pritje..... fq 37

I përulem zemrës..... fq 38
Gojëligët.....fq 39
Ngashërim.....fq 40
Rrokullisj.....fq 41
Si degë e thyer.....fq 42
Caqet e vetvetes.....fq 43
Shi malli..... fq 44
Puthja.....fq 45
Të përbuza, jo për të thënat
por për të pashprehurat..... fq 46
Akulldjegie.....fq 47
Sa vështirë.....fq 48
Vejushe.....fq 49
Ndjenjë e dhimbje..... fq 50
Etja e largësive.....fq 51
Mes vargjesh do të mbes..... fq 52
Më lini në mëkatet e mia.....fq 53
E di..... .....fq 54
Mungesë frymëzimi.....fq 55
Nëpër copëra mbrëmjesh.....fq 56
Shi malli më bie në shpirt,
por zjarri s`shuhet se s`shuhet..... fq 57
Copëza ndjenjash.....fq 58

Do të të jepem e tëra po me atë forcë

me të cilën s'do të të jepesha kurrë..... fq 68
Nëse.....fq 69

Vetëm tre..... .fq 70

Njeriu i mirë.....fq 71

Në kristal të deborës..... fq 72

Vrapit tim..... fq 73

Vetëm sytë e tu..... fq 75

Për të qenë me ty..... fq 76

Kohë e verdhë..... fq 77

Ç`të shashtisi..... fq 78

Vetmia në gjysmëdremitje griset

më ngacmon muzën e mendimit poezia..... fq 80

Të humbur..... fq 81

Një çast..... fq 82

Jargavitje..... fq 83

Ah, kjo dhimbje..... fq 84

E tillë kjo botë..... fq 85

Mosha..... fq 86

Kur s'të shoh ty..... fq 87

Kujdes me ndjenjën time

Një fill kam mes dashurisë e urrejtjes..... fq 88

Etje e trazuar..... fq 89

Fjalët e tua..... fq 90

Heshtje e shpresë..... fq 91

Risi trazuese..... fq 92

Koha..... fq 93

Dhimbja digjet brenda..... fq 94

S`di në ç`stinë..... fq 95

Dhimbjes s'i dorëzohem..... fq 96

& & &

Falënderim i veçantë për financuesit:

- Jonuz Bytyçi

- Dileman Nela

.....

Vera Istrefaj
Poezi
Faqe 100
Madhësia: 14 X 21
Shtëpia botuese: .....